



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAM ORIENTUES I MATURËS SHTETËRORE

PËR ARSIMIN E ORIENTUAR

(ARTISTIK)

DEGA: ART FIGURATIV

LËNDA:

“HISTORI ARTI”

(PROVIM ME ZGJEDHJE)

VITI SHKOLLOR 2024 – 2025

PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	3
2	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	4
3	STRUKTURA E TESTIT	5
4	TABELA E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË.....	12

1 HYRJE

Programi orientues për lëndën me zgjedhje histori arti përfshin njohuritë, konceptet dhe aftesitë më të rëndësishme të historisë së artit për shkollën e mesme me drejtim të orientuar artistike.

Programi orientues për provimin me zgjedhje histori arti, në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2024 -2025, përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme me drejtim të orientuar artistik, dega “Art figurativ”, për nxënësit e interesuar dhe për specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimin e Maturës Shtetërore.

Programi:

- Gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit që japid lëndën e historisë së artit në shkollat e mesme me drejtim të orientuar artistik, dega “Art figurativ”, që do të përgatisin maturantët për provimin histori arti, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Orienton nxënësit për materialet kyçe mësimore, njohuritë, konceptet dhe aftesitë kryesore, që ata duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin histori arti, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Përbën, gjithashtu, një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektësi nga specialistët e përfshirë në hartimin e fondit të pyetjeve dhe tezës së provimit histori arti, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.

Programi orientues “Histori arti” synon vlerësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në këtë lëndë dhe është strukturuar në bazë të disa rubrikave që ndjekin dhe sqarojnë njëra-tjetrën.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes dhe korrektësi nga secili prej grupeve të interesuara, sidomos, kujdes duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e fondit të pyetjeve dhe tezës së provimit histori arti, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore, **të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program**.

Vëmendje duhet të tregojnë këta specialistë edhe në lidhje me sigurimin e balancës midis përqindjes që zë secila temë studimi në këtë program me përqindjet që zënë këto tema në testin e provimit. Përgatitja e nxënësve për provimin histori arti duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh. Nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, koncepteve të historisë së artit dhe aftësive të përcaktuara në program. Për të arritur këtë, herë-herë ata duhet t'u rikthehen dhe çështjeve të ndryshme, të cilat nuk janë parashikuar në program, por që përmbyjnë informacion bazë për të përvetësuar materialin e zgjedhur për provim.

2 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues i lëndës me zgjedhje histori arti për provimin e Maturës Shtetërore të klasës XII bazohet në parimin se të zotërosh njoħuri artistike do të thotë të jesh në gjendje t'i zbatosh ato:

- në tematika të ndryshme të vetë lëndës histori arti;
- në situata të jetës së përditshme.

Programi orientues për përgatitjen e provimit me zgjedhje të lëndës histori arti është mbështetur në programet e lëndës histori arti, klasën e 11-12-të;

Për të qenë lehtësish i përdorshëm, programi përmban *strukturën e testit*, tematikat si dhe peshën e tyre.

Programi përmban rubrikën *e njoħurive dhe rezultateve të tē nxenit* ku përcaktohen njoħuritë, konceptet dhe aftesitë kryesore për çdo tematikë të lëndës histori arti.

3 STRUKTURA E TESTIT

Një nga aspektet më të rëndësishme në lëndën histori arti është zhvillimi i njojurive artistike në njojen, gjykimin dhe vlerësimin e artit në përgjithësi, ndikimin e artit në jetën kulturore, shkencore, politike, artistike të vendeve ku është kriuar, dhe vlerësimin e veprave të përfaqësuesve të ndryshëm, duke evidentuar dhe analizuar karakteristikat dhe risitë e çdo artisti.

Për secilën tematikë është **paraqitur pesha që zë secila prej tyre kundrejt orëve totale të lëndës histori arti përgjatë viteve të shkollimit në zhvillimin e njojurive artistike. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuqtojnë që përbajtja e testit duhet të zhvillohet në këtë renditje. Në përgatitjen për përbushjen e këtij programi orientues, do të përdoren programet e lëndës histori arti dhe tekstet me të cilat këto shkolla zhvillojnë studimin e kësaj lënde.**

Nr.	Tematika	Pesha	Përbajtja sipas tematikave
1.	Arti figurativ në Antikitet (3000 vjet p.e.s. – 400 e.s.)	10 %	<ul style="list-style-type: none">• Arti i mbretërive të vjetra:<ul style="list-style-type: none">○ Kultura Egjiptiane○ Arti asiro – babilonas ose i Mesopotamisë;○ 3 periudhat e artit grek;○ Arti romak – arkitektura dhe skulptura romake.• Ndikimet dhe karakteristikat e saj historike, shoqërore dhe kulturore;• Roli dhe besimi në zhvillimin e artit të këtyre kulturave, mënyrën e qeverisjes dhe të organizimit të jetës shoqërore;• Zhvillimi i skulpturës monumentale, të varrit, pikturen, arkitekturen, idenë mbi të bukurën dhe kanunet.
2.	Arti në Mesjetë (shekujt XI - XV)	5 %	Arti në periudhën e Mesjetës <ul style="list-style-type: none">• Arti bizantin: katedralet: Shën Sofi, Shën Vital, Shën Mark;• Arti romanik: Duomo i Pizës;

			<ul style="list-style-type: none"> • Arti gotik: arkitektura gotike në Francë; • Pararilindja dhe Kristianizmi në Europë: Pizano dhe Xhoto (Pisano, Giotto)
3.	Rilindja Europiane (shekujt XV - XVII)	10%	<p>Arti figurativ në periudhën e Rilindjes Europiane përmes njohjes me përfaqësuesit dhe me veprat e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rilindja e hershme: <ul style="list-style-type: none"> ○ Donatelo (Donatello) ○ Filipo Bruneleski (Filippo Brunelleschi) ○ Mazacio (Masaccio) • Rilindja Flamande: <ul style="list-style-type: none"> ○ Véllezér Vit Van Eyck (Hubert dhe Jan van Eyck) ○ Hugo vander Goes (Hugo van der Goes) ○ Rozhier van der Veiden (Rogier van der Weyden) ○ etj. • Rilindja gjermane <ul style="list-style-type: none"> ○ Albert Durer ○ Matias Grynvalt (Matthias Grunewald) ○ Hans Holbejn (Hans Holbein) ○ Etj. • Rilindja e largët Itali <ul style="list-style-type: none"> ○ Leonardo da Vinci ○ Mikelanxhelo (Michelangelo Buonarroti) ○ Rafaelo (Raffaello Sanzio) • Rilindja Veneciane <ul style="list-style-type: none"> ○ Xhorxhione (Giorgio Barbarelli da Castelfranco) ○ Ticiani (Tiziano Vecellio) ○ Veroneze (Veronese)

4.	Arti barok (shekujt XVII - XVIII)	10 %	<p>Arti në periudhën e Barokut përmes: tipareve, veprave dhe risive të përfaqësuesve kryesore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Arti Barok në Itali <ul style="list-style-type: none"> ○ Kavaraxho(Michelangelo Merisi da Caravaggio) ○ Lorenci Bernini (Gian Lorenzo Bernini) • Arti Barok në Spanjë <ul style="list-style-type: none"> ○ Esteban Murijo(Esteban Murillo) ○ El Greko(El Greco) ○ Velaskes(Diego Velázquez) ○ Goja(Francisco Goya) ○ Etj. • Arti Barok Flande dhe në Hollandë <ul style="list-style-type: none"> ○ Rubens(Peter Paul Rubens) ○ Van Deik (Anthony van Dyck) ○ Rembrand(Rembrandt van Rijn) ○ Franc Hals (Frans Hals) ○ Vermer(Johannes Vermeer) ○ Etj. • Arti Barok dhe Rokokoja në Francë <ul style="list-style-type: none"> ○ Nikolas Pusin (Nicolas Poussin) ○ Klod Loran(Claude Lorrain) ○ Pjer Puzhe(Pierre Puget) ○ Zhyl Mansar (Jules Mansart) ○ Antuan Vato(Jean-Antoine Watteau) ○ Fransua Bushe(François Boucher) ○ Simeon Shardë (Jean-Baptiste-Siméon Chardin) ○ Zhan Honore Frangomer (Jean-Honoré Fragonard) ○ Etj.
5.	Arti i kohës së re (shekujt XVII - XX)	15 %	<p>Arti në periudhën e Kohës së Re.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Neoklasiçizmi <ul style="list-style-type: none"> ○ Zhak Lui David (Jacques-Louis David)

- Antonio Konova(Antonio Canova)
- Bertel Torvaldsen (Bertel Thorvaldsen)
- **Arti romantik**
 - Teodor Zheriko (Théodore Géricault)
 - Ezhen Delakrúa(Eugène Delacroix)
 - Etj.
- **Arti në Rusi**
 - Ivan Surikov(Vasily Ivanovich Surikov)
 - Etj.
- **Arti realist**
 - Xhon Kostable(John Constable)
 - Uilliam Térner(Joseph Mallord William Turner)
 - Shkolla Barbizon
 - Gustav Kurbe(Gustave Courbet)
 - Honore Domie(Honoré Daumier)
 - August Roden (Auguste Rodin)
- **Arti nuovo**
 - Viktor Horte(Victor Horta)
- **Impresionizmi**
 - Klod Mone(Claude Monet)
 - Eduard Mane(Édouard Manet)
 - Edgar Degas(Edgar Degas)
 - August Renuar(Pierre-Auguste Renoir)
 - Etj.
- **Postimpresionizmi**
 - Pol Sezan(Paul Cézanne)
 - Vinsent Van Gog (Vincent van Gogh)
 - Pol Gogen(Paul Gauguin)
 - Zhorzh Sera(Georges-Pierre Seurat)
 - Etj.

6.	Arti në shekullin XX	15 %	<p>Arti figurativ në gjysmën e parë të shekullit XX:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Pikturë <ul style="list-style-type: none"> ○ Matis(Henri Matisse) ○ Xhorxh Brak (Georges Braque) ○ Vasili Kandiskij ○ Emil Nolde ○ Umberto Boçioni(Umberto Boccioni) ○ Salvador Dali ○ Marsel Dyshamp (Marcel Duchamp) ○ Etj. ● Arkitektura <ul style="list-style-type: none"> ○ Antonio Gaudi ○ Roe Vandernies ○ Valter Gropius(Walter Gropius) ● Skulpturë <ul style="list-style-type: none"> ○ Emil Burdel(Émile Antoine Bordelles) ● Arti i postimpresionistëve dhe lëvizje të reja avangardë.
7.	Arti ilir dhe i qyteteve antike bregdetare	5 %	<ul style="list-style-type: none"> ● Arti ilir dhe i qyteteve antike bregdetare: <ul style="list-style-type: none"> ○ Butrinti ○ Apollonia ○ Dyrrahu ○ Orikumi
8.	Arti bizantin	5 %	<ul style="list-style-type: none"> ● Arti bizantin - arkitektura: <ul style="list-style-type: none"> ○ Kisha e Shën Kollit, Perondi – Kuçovë ○ Manastiri i Mesopotamisë – Delvinë ○ Kisha e Shën Vllahernës, Berat ○ Kisha e Shën Marisë, -Kosinë – Përmet. ○ Etj. ● Piktura <ul style="list-style-type: none"> ○ Pikturat e kishës së Bllashtanjës

			<ul style="list-style-type: none"> <input type="radio"/> Pikturat e manastirit të Pojanot – Fier <input type="radio"/> Ishulli – Mali i Gradit <input type="radio"/> Shën Jovani - Boboshticë
9.	Arti pasbizantin	5 %	<ul style="list-style-type: none"> ● Arti pas bizantin: <ul style="list-style-type: none"> <input type="radio"/> Onufri <input type="radio"/> Nikolla Onufri – i biri <input type="radio"/> Onufri qiprioti <input type="radio"/> David Selenicasi <input type="radio"/> Kostandin Shpataraku <input type="radio"/> Vellezërit Zograf <input type="radio"/> Vellezërit Çetini
10.	Art i Rilindjes Kombëtare Shqiptare	5 %	<ul style="list-style-type: none"> ● Arti i Rilindjes Kombëtare Shqiptare: <ul style="list-style-type: none"> <input type="radio"/> Kol Idromeno <input type="radio"/> Jorgji Panariti <input type="radio"/> Spiro Xega <input type="radio"/> Murat Toptani <input type="radio"/> Simon Rrota <input type="radio"/> Ndoc Martin Camaj
11.	Arti i periudhës së Pavarësisë	5 %	<p>Arti i periudhës së Pavarësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Piktura <ul style="list-style-type: none"> <input type="radio"/> Vangjus Mio <input type="radio"/> Andrea Kushi <input type="radio"/> Zef Kolumbi ● Skulptura <ul style="list-style-type: none"> <input type="radio"/> Odhise Paskali
12.	Arti i periudhës së pas çlirimit (1945 deri më sot)	10 %	<p>Arti i periudhës pas Çlirimit (1945 deri më sot):</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Piktura <ul style="list-style-type: none"> <input type="radio"/> Sadik Kaceli <input type="radio"/> Abdurrahim Buza <input type="radio"/> Nexhmedin Zajmi <input type="radio"/> Kel Kodheli <input type="radio"/> Guri Madhi <input type="radio"/> Fatmir Haxhiu

- Vilson Kilica
- Zef Shoshi
- Sali Shijaku
- Danish Shukriu
- Ismail Lukani
- Etj.

- **Skuptura**

- Odhise Paskali
- Andrea Mano
- Janaq Pano
- Llazar Nikolla
- Kristaq Rama
- Shaban Hadëri
- Muntaz Dhrahmi
- Hektor Dule
- Perikli Çuli
- Fuat Dushku
- Ibrahim Kodra
- Mysli Mulliqi
- Shyqyri Nimani
- Etj.

4 TABELA E REZULTATEVE TË TË NXËNIT PËR SECILËN TEMATIKË

Për secilën tematikë, më poshtë paraqiten njohuritë dhe rezultatet e të nxënët që duhet të demonstrojë nxënësi për të përm bushur kompetencat artistike nëpërmjet lëndës histori arti. Megjithëse njohuritë përcaktohen për secilën tematikë ato trajtohen të integruara dhe të lidhura me njëra - tjetrën.

TEMATIKA: Arti figurativ në Antikitet (3000 vjet p.e.s. – 400 e.s.)

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënët për realizimin e kompetencave artistike
Arti figurativ në Antikitet (3000 vjet p.e.s. – 400 e.s.)	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">• Njohin zhvillimin e artit figurativ në antikitet;• shpjegojnë sistemin shoqëror dhe risitë e kësaj periudhe;• analizojnë gjinitë e artit sipas epokave;• përcaktojnë format dhe teknikat;• shpjegojnë tiparet kryesore të kësaj periudhe.

TEMATIKA: Arti në Mesjetë (shekujt XI - XV)

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënësit për realizimin e kompetencave artistike
Arti në Mesjetë (shekujt XI - XV)	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">• njohin zhvillimin e artit figurativ në Mesjetë;• shpjegojnë rolin e kishës, fuqizimin e feudalizmit, kërkesa e tyre, zhvillimet sociale;• shpjegojnë:<ul style="list-style-type: none">○ karakteristikat e artit biznatin;○ karakteristikat e artit romanik;○ karakteristikat e artit gotik;○ karakteristikat e artit të Pararilindjes;• krahasojnë periudhat midis tyre.

TEMATIKA: Rilindja Europiane (shekujt XV - XVII)

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënësit për realizimin e kompetencave artistike
Rilindja Europiane (shekujt XV - XVII)	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • njojin zhvillimin e artit figurativ në Rilindjen Europiane; • kuptojnë ndikimin e zhvillimeve shoqërore, historike dhe artistike në artin figurativ; • shpjegojnë karakteristikat e kësaj periudhe, si: <ul style="list-style-type: none"> ○ Forcimi i borgjezisë. ○ Zbulimet e mëdha gjeografike. ○ Reformacioni i kishës. ○ Zhvillimi i teknikës. ○ Filozofia humaniste. • njojin autorët kryesorë dhe veprat e tyre; • argumentojnë rreth përsosjes së teknikave artistike në artet figurative; • bëjnë dallimet në kohë dhe në hapësirë.

TEMATIKA: Arti barok (shekujt XVII - XVIII)

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënësit për realizimin e kompetencave artistike
Arti barok (shekulli XVII - XVIII)	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">• njohin zhvillimin e artit barok dhe vendet ku u zhvillua;• shpjegojnë diferencat kulturore midis vendeve të ndryshme dhe artistëve të tyre;• shpjegojnë zhvillimin e artit;• argumentojnë pse arti në këtë periudhë ishte në shërbim të fesë dhe politikës;• njohin veprat e autorëve kryesorë të kësaj periudhe;• shpjegojnë zhanret kryesore dhe evoluimin e teknikave artistike.

TEMATIKA: Arti i kohës së re (shekujt XVII - XX)

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënësit për realizimin e kompetencave artistike
Arti i kohës së re (shekujt XVII - XX)	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">• njohin zhvillimin e artit të Kohës së Re;• shpjegojnë zhvillimet historike, terrenin social ekonomik ku u zhvilluan;• kuptojnë Revolucionin tekniko shkencor dhe risitë;• shpjegojnë ndarjen e epokave dhe dallimet midis rrymave;• njohin veprat dhe autorët kryesorë të kësaj periudhe;• shpjegojnë zhvillimet teknologjike dhe jetën moderne.

TEMATIKA: Arti në shekullin XX

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënësit për realizimin e kompetencave artistike
Arti në shekullin XX	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">• njohin zhvillimin e artit në shekullin XX;• shpjegojnë rolin e politikës dhe të ekonomisë;• njohin dhe përcaktojnë artistët novatorë;• shpjegojnë ndryshimet e vazhdueshme të artit në këtë periudhë;• përcaktojnë qartë rrymat artistike dhe autorët;• njohin veprat dhe autorët kryesorë të kësaj periudhe;• shpjegojnë ndryshimet në përbajtje dhe zhvillimet e teknologjisë.

TEMATIKA: Arti figurativ shqiptar

Njohuritë artistike	Rezultatet e të nxënësit për realizimin e kompetencave artistike
Arti figurativ shqiptar	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • njohin zhvillimin e arkitekturës, skulpturës dhe artizanatit në artin ilir; • kuptojnë huazimet nga kulturat greke dhe romake në artin ilir; • bëjnë dallimin midis artit ilir dhe atij me ndikime grekoromake; • japid shembuj konkretë me toponime dhe data; • njohin epokën kur lindi arti bizantin në Shqipëri; • njohin karakteristikat kryesore të artit bizantin; • përcaktojnë tiparet e veprave dhe vendndodhjen e tyre; • njohin artistë të kësaj periudhe; • shpjegojnë pse Kristianizmi ishte sunduesi i botës shpirtërore të njeriut në këtë periudhë; • shpjegojnë pse piktura për njeriun është si Bibla për atë që di të lexojë; • njohin rolin vendimtar të pikturës pasbizantine, si themel i trashëgimisë historike, kulturore dhe shpirtërore; • njohin autorët kryesore të periudhës pasbizantine dhe veprat e tyre; • kuptojnë se si ndodhi shkëputja përfundimtare nga arti mesjetar; • shpjegojnë tiparet kombëtare të artit të periudhës së Rilindjes, të shprehura në punët e artistëve patriotë me formim perëndimor; • përcaktojnë autorët dhe veprat e tyre në periudhën e

Rilindjes Kombëtare;

- kuptojnë rolin patriotik të krijimtarisë artistike në periudhën e Rilindjes Kombëtare;
- njojin periudhën e Pavarësisë dhe zhvillimet sociale, ekonomike dhe politike;
- shpjegojnë disa nga kërkesat që shtroheshin për zgjidhje dhe evolucionin e artit figurativ;
- përcaktojnë risitë e artit shqiptar në periudhën e Pavarësisë;
- njojin autorët kryesorë në skulpturë dhe pikturë dhe veprat e tyre, në periudhën e Pavarësisë;
- njojin rolin e artit në periudhën e realizmit socialist;
- shpjegojnë çfarë është tabloja kompozicionale tematike në shërbim të ideologjisë;
- kuptojnë rolin e institucioneve shtetërore artistike gjatë periudhës së viteve 1945-1990;
- njojin skulpturat monumentale politike;
- kuptojnë zhvillimet në varësi të trysnive politike;
- njojin autorët kryesorë dhe veprat e tyre sipas gjinive të artit;
- njojin autorët kryesorë të trevave shqiptare.